

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“Light UP” Sh.P.K.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria **Light UP Sh.P.K** rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë Tregtare.

Neni 1

Data e themelimit

Me vullnetin e lirë të ortakëve, në bazë të aktit të themelimit të datës 10 Maj 2021, u krijua shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Light UP” Sh.P.K.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në qytetin e TIRANËS, Njësia Bashkiake nr.10, Rruga e Durrësit, Godina 204, Hyrja 2 por me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve, mund të ngrihen edhe degë, filiale apo dhe seli në vende të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Shtetit Shqiptar.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Import–Eksport si dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve dhe artikujve të ndryshëm elektrik, hidraulike, sanitare, ndriçues, ndërtimi, produkte industriale, elektroshtëpiake, por pa u kufizuar vetëm në këto.

Projektim, zbatim, vendosje dhe mirëmbajtje e sistemeve elektrike, hidraulike, ndriçues.

Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në Status.

Neni 5

Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota, i cili është tërësisht kapital financiar e përbëhet nga kontributi i ortakëve si më poshtë:

Z. Erald Selimi, i datëlindjes 29.07.1987, lindur në Tepelenë, me shtetësi shqiptare, pajisur me numër NID I70729021T; zotëron 1 (një) kuotë e njësuar me 50% të kapitalit, me vlerë nominale të barabartë me 50 Lekë (pesëdhjetë) lekë.

Z. Spiro Toqe, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.05.1998, lindur në Ersekë, mbajtës i letërnjoftimit me nr.NID J8052003P; zotëron 1 (një) kuotë e njësuar me 50% të kapitalit, me vlerë nominale të barabartë me 50 Lekë (pesëdhjetë) lekë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributeve të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët kanë të drejtë ta tjetersojnë këtë kapital, të shtojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Neni 7

Fondet Rezervë

Shoqëria krijon fondet rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike, duke disponuar lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve të krijuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 8

Transferimi i kuotave

Kuotat e ortakëve mund të transferohen lirisht me anë trashëgimie ligjore apo testamentare tek trashëgimtarët ligjorë, apo të disponohen lirisht prej secilit ortak me akt noterial, pas miratimit paraprak të ortakëve të shoqërisë.

Neni 9 Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratorët në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10 Shpërndarja e fitimeve

Në përfundim të mbylljes së bilancit administratorët përcaktojnë mënyren e shpërndarjes së fitimit, likuidimin e detyrimeve dhe rezervat ligjore.

Ortakët kanë të drejtë të mbajnë pjesën e fitimit të deklaruar nga pasqyrat financiare të Shoqërisë.

III. ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

1 – *Asambleja e ortakëve* e cila përbëhet prej dy ortakëve themelues

2- *Administratorët* e deleguar të shoqërisë që do të jenë:

Z. Erald Selimi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.07.1987, lindur në Tepelenë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. NID I70729021T;

Z. Spiro Toqe, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.05.1998, lindur në Ersekë, mbajtës i letërnjoftimit me nr.NID J80520030P;

Shoqëria përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Asambleja e Ortakëve merr vendime për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimet e Statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve ;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti

IV. MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 11

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

Neni 12

Të gjithë të zgjedhurit nga Asambleja e Ortakëve, nëpunësit të cilët punojnë për llogari të shoqërisë mbajnë përgjegjësi civile dhe penale sipas legjislacionit në fuqi që regullon marrëdhëniet e punës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara dhe i shkaktojnë dëme Shoqërisë.

V. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Kjo Shoqëri do të shpërbëhet në rastin kur Asambleja e Ortakëve vendos për shpërbërjen e Shoqërisë duke emëruar një ose më shumë likuidatorë.

Neni 13

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e shpërbërjes së saj pas shlyerjes së detyrimeve tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve, përcaktohen pasuritë e ngelura të cilat i kthehen terësisht ortakëve të shoqërisë.

Neni 14

Kur Asambleja e Ortakëve pa shkaqe të arsyeshme nuk vendos të miratojë bilancin e likuidimit dhe mbi procedurën e rregullt të likuidimit, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë prej gjykatës likuidimin dhe mbylljen e kësaj shoqërie.
Aktet e mbylljes dhe likuidimit të shoqërisë së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare depozitohen në regjistrin tregtar dhe më pas shoqëria ç'regjistrohet prej saj.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.


Neni 16

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Statuti u nënshkrua sot më datë 10 Maj 2021 (dhjetë maj dymijë e njëzet e një) në 3 (tre) kopje të barazvlefshme të tij.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE:

1. ERKUD SELIMI 
2. Spino Toçe 